

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë Rishikimi i gjendjes aktuale

shkurt 2022

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (nëntor 2021 – janar 2022) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (tetor 2021). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Perspektiva e ekonomisë globale për vitin 2022 është më pak e favorshme krahasuar me vlerësimet e tetorit, me vlerësimin e rritjes globale të rishikuar në mënyrë të moderuar në rënie, në kontekstin e përhapjes së shpejtë të llojit të ri të virusit korona "omikron" në mbarë botën dhe rivendosjen e masave më të rrepta kufizuese për mbrojtjen e shëndetit publik. Nga ana tjetër, projeksioni i vitit 2023 është rishikuar në rritje, kryesisht për shkak të efekteve të baze më të ulët krahasuese. Në të njëjtën kohë, pasiguria në lidhje me rritjen e ardhshme globale është ende e theksuar dhe rreziqet që rrethojnë projeksionet janë ende në rënie. Rreziku kryesor në rënie akoma është i lidhur ngushtë me rrjedhën e ardhshme të pandemisë, respektivisht me shqetësimin për përhapjen globale dhe shfaqjen e llojeve të reja të virusit, të cilat do të zgjasin pandeminë dhe do të çonin në ndërprerje të reja të flukseve ekonomike globale. Pasiguri shtesë vjen nga shtrëngimi i mundshëm më i shpejtë i politikës monetare në vendet e zhvilluara, veçanërisht nëse inflacioni vazhdon të jetë më i lartë se sa pritej, gjë që mund të ketë efekte negative në stabilitetin financiar dhe pozicionet fiskale të vendeve me rritje të shpejtë me borxhe të larta. Rrezik i ri dhe më i theksuar për ekonominë globale është ndezja e tensioneve gjeopolitike në Europën Lindore dhe Azi, ku përshkallëzimi eventual i konfliktit ruso-ukrainas mund të shkaktojë rritje të mprehtë të çmimeve të energjisë primare dhe produkteve joenergjetike, destabilizimin e flukseve të tregtisë globale dhe rritjes së paqëndrueshmërisë në tregjet financiare, me efekte negative si në inflacionin global, ashtu edhe në rimëkëmbjen ekonomike globale. Kohëzgjatja e mundshme e ndërprerjeve në zinxhirët e furnizimit global dhe rritja e mundshme më e ngadaltë e ekonomisë kineze përbëjnë gjithashtu rrezik të konsiderueshëm në rënie për ekonominë globale. Rreziqe të tjera aktuale globale janë ato në anën e furnizimit me energji dhe shfaqja e mundshme e trazirave sociale dhe fatkeqësive natyrore. Sa u përket **zhvillimeve ekonomike në Eurozonë**, si partneri ynë kryesor tregtar, të dhënat fillestare tregojnë për rimëkëmbje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik në tremujorin e katërt të vitit 2021, me PBB-në reale që ka arritur rritje të forcuar prej 4,6% në bazë vjetore (3,9 në tremujorin e mëparshëm). Me këtë, ekonomia e Eurozonës në fund të vitit të kaluar arriti nivelin para pandemisë (në fund të vitit 2019). Për të gjithë vitin 2021, rritja e parashikuar e PBB-së në Eurozonë është 5,2% (-6,4% në 2020). Nga pikëpamja e të dhënave më të fundit të frekuencës së lartë për tremujorin e parë, treguesit nga anketat e subjekteve ekonomike për janarin janë disi më pak të favorshëm krahasuar me muajin paraardhës, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së sektorit të shërbimeve të përhapjes së përgjithshme të llojit "omikron" dhe rikthimit të masave kufizuese, ndërkohë që treguesit e industrisë patën një përmirësim. Nga ana tjetër, partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, Gjermania, pati rritje të ngadaltë të PBB-së në 1,4% nga viti në vit në tremujorin e katërt (2,9% në tremujorin e tretë), e ndikuar kryesisht nga shtrëngimi i masave kufizuese për t'u përballur me vala e re e pandemisë dhe abstënimin në rritje të popullsisë nga konsumi. Ndryshe nga zhvillimet në Eurozonë, anketat në Gjermani tregojnë për përmirësim të ndjeshëm të aktivitetit gjatë janarit, me zhvillime më të favorshme si në industrinë e prodhimit ashtu edhe në sektorin e shërbimeve, gjë që vjen si pasojë e efekteve më pak negative të mutacionit omikron në ekonominë gjermane dhe shenjat fillestare për të reduktuar vonesat në furnizimin e lëndëve të para. Sipas raporteve fillestare, tregu i punës në eurozonë vijon të shohë zhvillime të favorshme, ku shkalla e papunësisë në tremujorin e katërt të 2021 ra në 7,1% (7,6% në tremujorin e mëparshëm). Për sa i përket inflacionit në Eurozonë, të dhënat e vlerësuara për muajin janar tregojnë përshpejtimin e tij të mëtejshëm, me rritjen e çmimeve që ka arritur nivel historikisht të lartë prej 5,1% me bazë vjetore (5% në dhjetor), kryesisht si rezultat i arritjeve më të larta në

komponentët e energjisë dhe ushqimit, ndërkohë që inflacioni bazë shënoi rritje të ngadaltë, për herë të parë që nga korriku 2021. Në mbledhjen e rregullt të muajit shkurt, BQE-ja mbajti përcaktimin e politikës monetare, por u tregua më kufizuese për sa i përket ndryshimeve të mundshme në të ardhmen, në kushtet e inflacionit më të lartë se sa pritej dhe rreziqeve në rritje në raport me projeksionet. E gjithë kjo ka ndikuar që pjesëmarrësit e tregut të presin që procesi i rritjes së normave të interesit të nisë më shpejt, ndaj sipas çmimeve më të fundit pritet që në vitin 2022 **norma e interesit të huaj EURIBOR** njëmuore të jetë në të njëjtin nivel si në projeksionin e tetorit, ndërkohë që për vitin 2023 është kryer korrigjim rritës më i rëndësishëm, në pajtim me pritjet e tregut për një normalizim gradual të politikës monetare të BQE-së.

Shikuar përmes treguesve të veçantë sasiorë të mjedisit të jashtëm domethënës për ekonominë e Maqedonisë, projeksioni për kërkesën e huaj efektive për vitin 2021 është i njëjtë, për vitin 2022 është rishikuar mesatarisht në rënie, ndërsa për vitin 2023 në rritje, në raport me vlerësimet e tetorit. Nga ana tjetër, në rastin e **inflacionit të huaj efektiv** vërehet realizim më i lartë në vitin 2021 dhe njëkohësisht janë bërë korrigjime në rritje të projeksioneve për vitin 2022 dhe 2023. Vlerësimet e reja për **kursin valutor euro/dollarë amerikanë** norma tregon rishikim në rritje të vlerës së dollarit amerikan në vitin 2022 dhe një rishikim në rënie për vitin 2023. **Çmimet e produkteve primare në bursat botërore në vitin 2021 shënuan rritje të ndjeshme**, e cila është pak më e lartë se rritja në projeksionet e tetorit. Gjithashtu, **pritjet e fundit për çmimet e produkteve primare në bursat botërore janë rishikuar në rritje për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 korrigjimet janë përgjithësisht në rënie në raport me vlerësimet e tetorit.** Kështu, në vitin 2022 pritet rritje më e lartë e çmimeve të produkteve primare, ndërsa në vitin 2023 pritet që shumica e tyre të kenë rënie më të fortë të çmimeve. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të lëndëve të para janë jashtëzakonisht të luhatshme dhe aktualisht ndikohen nga zhvillimet në lidhje me pandeminë Kovid-19, e cila krijon pasiguri më të madhe për dinamikën dhe efektet e tyre në të ardhmen në ekonominë vendase, si në afat të shkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë.

Krahasimi i treguesve të fundit makroekonomikë të ekonomisë vendase me dinamikën e tyre të parashikuar brenda ciklit të projeksioneve të tetorit, tregon për devijime të caktuara në segmente të caktuara të ekonomisë. Sipas të dhënave të publikuara të vlerësuara të PBB-së, në tremujorin e tretë të 2021 PBB-ja reale regjistroi rritje prej 3% në bazë vjetore. Këto arritje tregojnë se ekonomia vendase vazhdon rimëkëmbjen, në kushtet e imunizimit të mëtejshëm të popullsisë dhe pa efekte të mëdha negative nga shfaqja e valës së katërt të Kovid-19 në këtë periudhë. Mesatarisht, në tre tremujorët e parë të vitit 2021, ekonomia shënoi rritje reale prej 4,6%, që është afër pritshmërive nga projeksioni i tetorit. Për sa i përket aktivitetit ekonomik në tremujorin e katërt të vitit 2021, të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë kryesisht tregojnë për rritje të mëtejshme, por të ngadalësuar, vjetore të aktivitetit ekonomik dhe efekte relativisht të kufizuara të përhapjes së valës së pestë të pandemisë, të shoqëruara me llojin "omikron" të Kovid-19 në fund të tremujorit. Konkretisht, të dhënat për këtë periudhë tregojnë ritme të larta, por më të moderuara të rritjes vjetore të qarkullimit në tregtinë dhe mikpritjen totale dhe ngadalësim të rënies së prodhimit industrial, ndërsa në punimet e ndërtimit të kryera në periudhën tetor-nëntor, është vërejtur rënie vjetore e mëtejshme. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, në janar 2022 u arrit një normë vjetore e inflacionit prej 6,7%, e cila është arritje më e lartë krahasuar me parashikimet e fundit.** Përsheptimi i dinamikës vjetore të inflacionit është reflektim i rritjes së çmimeve të rregulluara të energjisë, si dhe i rritjes së disa produkteve ushqimore që kanë dinamikë të ndryshueshme. Kontributi i inflacionit bazë (inflacioni në të cilin përjashtohet ndikimi i çmimeve të ushqimeve dhe energjisë elektrike) në rritjen e nivelit të çmimeve mbetet i moderuar dhe i qëndrueshëm. Prandaj, presionet e çmimeve ende rrjedhin kryesisht nga faktorët e ofertës, të lidhur me ndryshimet e çmimeve në tregjet globale dhe ndikimin e pandemisë. Inflacioni i realizuar është mbi projeksionin dhe pritjet për dinamikën e ardhshme të çmimeve të importit janë korrigjuar në drejtim rritës, me çka janë rritur edhe rreziqet për projeksionin e inflacionit në afat të shkurtër. Megjithatë, institucionet ndërkombëtare presin stabilizimin e rritjes së këtyre çmimeve në gjysmën e dytë të vitit dhe si rrjedhojë uljen e presioneve inflacioniste. Në të njëjtën kohë, vazhdon të theksohet pasiguria dhe dinamika e lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, në pajtim me efektet e pasigurta ekonomike që lidhen me zhvillimin dhe trajtimin e

pandemisë dhe tensionet aktuale gjeopolitike, si si dhe pasiguria e shtuar e tregjeve botërore të energjisë.

Sipas treguesve të mjaftueshmërisë, rezervat valutore janë ende në zonën e sigurt dhe arritjet e muajit janar janë brenda pritshmërive për tremujorin e parë të vitit 2022, në pajtim me projeksionin e tetorit. Për sa i përket të dhënave të disponueshme nga sektori i jashtëm, të dhënat për tregun valutor për muajin janar 2022, tregojnë për arritje në transfertat private, brenda pritshmërive për tremujorin e parë të vitit 2022. Megjithatë, të dhënat në dispozicion i referohen një periudhe të shkurtër dhe nuk janë të mjaftueshme për të nxjerrë përfundime më të sakta. Në të njëjtën kohë, të dhënat e tregtisë së jashtme për tremujorin e katërt 2021 tregojnë për një deficit tregtar të realizuar pak më të lartë krahasuar me pritjet për tremujorin e fundit të 2021, në përputhje me projeksionin e tetorit.

Sa i përket lëvizjeve në sektorin monetar, të dhënat e muajit dhjetor tregojnë për rritje mujore të **gjithsej depozitave** prej 2,5% (rritje mujore prej 1% në muajin nëntor), e cila vjen kryesisht si rezultat i kontributit pozitiv të depozitave të amvisërive dhe ndërmarrjeve. Nga pikëpamja valutore, rritja mujore e gjithsej depozitave është pothuajse në mënyrë të barabartë si pasojë e rritjes së depozitave (në tërësi si rezultat i rritjes së parave depozituese) dhe depozitave në valutë. Në bazë vjetore, gjithsej depozitat në muajin dhjetor ishin më të larta me 7,5%, që është mbi rritjen e parashikuar vjetore (prej 7,1%) për fundin e tremujorit të katërt 2021. **Totali i kredive** në muajin dhjetor është rritur me 1,7% në bazë mujore (rritje mujore prej 0,8% në nëntor), kryesisht si rezultat i kontributit pozitiv të kredisë së korporatave, me kontribut pozitiv më të moderuar të kredisë për amviseritë. Sipas strukturës valutore, rritja e kredisë vjen më së shumti nga kredia në valutën vendase, me kontribut më të vogël pozitiv të kredisë në valutë. Në bazë vjetore, rritja e totalit të kredisë vijon të përshpejtohet dhe në muajin dhjetor arriti në 8,3%, me rritje të parashikuar në fund të tremujorit të katërt të vitit prej 7,1%, në pajtim me projeksionin e tetorit.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2021 është realizuar deficit prej 38.783 milionë denarë. Deficiti buxhetor financohet plotësisht përmes huamarrjes së shtetit në tregun e jashtëm dhe të brendshëm, ku një pjesë e hyrjeve mbahen si depozita shtetërore në Bankën Popullore. Deficiti buxhetor i realizuar në vitin 2021 përfaqëson 83,9% të deficitit të parashikuar nga rishpërndarja e buxhetit për vitin 2021.

Ndonëse treguesit dhe vlerësimet e fundit makroekonomike ende tregojnë për mjedis kryesisht të pandryshuar për zbatimin e politikës monetare, arritjet inflacioniste dhe pritshmëritë për shtrëngim më të shpejtë të kushteve financiare botërore imponojnë nevojën për mbikëqyrje vigjilente të situatës. Rezervat valutore janë ende në nivelin e duhur dhe në zonën e sigurt dhe arritjet në muajin janar janë brenda pritshmërive për tremujorin e parë të vitit 2022. Arritjet në tre tremujorët e parë të vitit 2021 në produktin e brendshëm bruto janë relativisht afër atyre të parashikuara dhe të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik për tremujorin e katërt tregojnë për rritje të mëtijshme të ekonomisë. Përsa i përket inflacionit, arritjet e janarit 2022 janë mbi ato të parashikuara dhe pritjet për çmimet e produkteve të importuara janë korrigjuar në rritje, gjë që tregon për rreziqe në rritje dhe nevojën për mbikëqyrje të kujdesshme. Lëvizja e çmimeve të produkteve primare, e veçanërisht e produkteve të karburanteve, është ende jashtëzakonisht e ndryshueshme dhe e pasigurt, si dhe ndikimi i tyre i transferuar në çmimet e tjera në ekonominë vendase në periudhën e ardhshme. Në sektorin monetar, rritja vjetore e depozitave dhe e kredisë në muajin dhjetor është mbi atë të parashikuar për tremujorin e katërt 2021, sipas projeksionit të tetorit.

Rritja e mbështetjes kreditore të ekonomisë vendase

Sektori bankar ka forcuar ndjeshëm mbështetjen e kredisë për sektorin privat gjatë vitit 2021 dhe ka kontribuar në rimëkëmbjen e ekonomisë vendase. Gjatë vitit 2021, shuma e përgjithshme e flukseve të kredisë arriti në 29.588 milionë denarë, pothuajse në mënyrë të barabartë për ndërmarrjet dhe ekonomitë e amvisërive. Me këtë, shkalla vjetore e rritjes së kredive arriti në 8,3%, me një përshpejtim të dukshëm të shkallës së rritjes së kreditimit për sektorin e korporatave. Rritja e kreditimit gjatë vitit 2021 është rezultat i pozicionit të favorshëm të kapitalit dhe likuiditetit të bankave dhe kontribut shtesë ka dhënë natyra e mëtejshme përshtatëse e politikës monetare, si dhe paketa shtetërore e masave për mbështetjen e aktivitetit kreditues.


Këto arritje janë në pajtim me rritjen e kërkesës për kredi gjatë vitit 2021, në të dy sektorët, si dhe me lehtësimin e mëtejshëm të kushteve të kreditimit për amvisëritë, në pajtueshmëri me parashikimet e bankave të shprehura në Anketën për aktivitetin kreditor.

Селектирани макроекономски показатели ^{/1}				2020							2021													2022			
	2016	2017	2018	2019	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	2020	јан.	фев.	март	Кв.1	апр.	мај	јун.	Кв.2	јул.	авг.	сеп.	Кв.3	окт.	ное.	дек.	Кв.4	2021	јан.
I. Реален сектор индикатори																											
Бруто домашен производ (годишна реален раст) ^{/2}																											
	2,8	1,1	2,9	3,9	-1,3	-16,4	-5,9	-0,8	-6,1				-1,8				13,4				3,0						
Индустриско производство ^{/3}																											
стапка на промена (годишна)	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-25,0	-7,5	-2,3	-9,5	-13,5	-12,2	7,6	-6,1	46,1	16,5	9,5	22,2	-0,6	-1,4	-8,0	-3,5	-6,5	4,7	-4,9	-2,3	1,4	
кумулативна просечна стапка	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-14,6	-12,1	-9,5	-9,5	-13,5	-12,8	-6,1	-6,1	3,7	6,0	6,6	6,6	5,4	4,5	2,9	2,9	1,8	2,1	1,4	1,4	1,4	
Инфлација ^{/4}																											
ЦПИ Инфлација (годишна) ^{/5}	-0,2	2,4	0,9	0,4	0,6	0,5	1,5	2,2	2,3	1,9	1,9	2,1	2,0	2,7	3,0	2,7	2,8	3,4	3,6	3,7	3,5	4,1	4,8	4,9	4,6	4,9	6,7
ЦПИ Инфлација (кумулативна просечна)	-0,2	1,4	1,5	0,8	0,6	0,5	0,9	1,2	1,2	1,9	1,9	2,0	2,0	2,2	2,3	2,4	2,4	2,5	2,7	2,8	2,8	2,9	3,1	3,2	3,2	3,2	6,7
Базична инфлација (кумулативна просечна)	1,3	2,3	1,5	0,5	0,7	0,6	0,7	0,9	0,9	1,8	1,7	1,6	1,6	1,6	1,7	1,8	1,8	2,0	2,1	2,2	2,2	2,2	2,3	2,4	2,4	3,2	6,7
Базична инфлација (годишна) ^{/5}	1,0	2,8	1,4	-0,3	0,7	0,5	0,8	1,6	1,9	1,8	1,6	1,5	1,6	1,7	1,9	2,5	2,0	3,0	2,8	2,9	2,9	2,9	3,1	2,9	3,0	2,9	3,2
Работна сила																											
Стапка на невработеност	23,7	22,4	20,7	17,3	16,2	16,7	16,5	16,1	16,4				16,0				15,9				15,7						
II. Фискален сектор индикатори																											
(Централен Буџет и Буџети на фондови)																											
Вкупни буџетски приходи	169.356	179.673	188.505	203.822	46.484	40.923	48.585	53.562	189.554	14.810	16.435	17.673	48.918	19.292	15.735	17.464	52.491	20.205	17.167	19.347	56.719	20.063	19.128	21.186	60.377	218.505	
Вкупни буџетски расходи	185.407	196.561	200.071	217.445	53.895	59.458	58.511	71.557	243.421	17.520	19.189	19.106	55.815	19.263	20.767	21.243	61.273	23.353	22.525	19.734	65.612	19.039	25.597	29.952	74.588	257.288	
Буџетско салдо (готовинска основа)	-16.051	-16.888	-11.566	-13.623	-7.411	-18.535	-9.926	-17.995	-53.867	-2.710	-2.754	-1.433	-6.897	29	-5.032	-3.779	-8.782	-3.148	-5.358	-387	-8.893	1.024	-6.469	-8.766	-14.211	-38.783	
Буџетско салдо (% од БДП) ^{/1}	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-1,1	-2,8	-1,5	-2,7	-8,2	-0,4	-0,4	-0,2	-0,9	0,0	-0,7	-0,5	-1,2	-0,4	-0,7	-0,1	-1,2	0,1	-0,9	-1,2	-2,0	-5,3	
III. Финансиски индикатори ^{/6}																											
Парична маса (M4), годишна стапка на раст																											
	6,2	5,1	11,8	9,3	8,9	9,8	6,9	6,9	6,9	7,7	8,2	7,9	7,9	7,1	7,0	6,7	6,7	7,1	9,6	8,2	8,2	7,8	7,6	7,0	7,0	7,0	7,0
Вкупни кредити, годишна стапка на раст																											
	-0,1	5,4	7,3	6,0	5,8	6,6	7,3	4,7	4,7	4,6	4,4	5,2	5,2	5,7	5,6	5,1	5,1	5,2	6,4	6,3	6,3	6,7	7,7	8,3	8,3	8,3	
Вкупни кредити на население	7,0	9,2	10,3	10,5	10,1	8,8	9,5	8,0	8,0	7,4	7,1	8,1	8,1	8,9	8,8	8,7	8,7	8,0	7,9	7,5	7,5	7,3	7,7	7,8	7,8	7,8	
Вкупни кредити на претпријатија	-5,3	2,3	4,5	1,9	1,8	4,6	5,2	1,1	1,1	1,6	1,4	2,1	2,1	2,3	2,1	1,2	1,2	2,0	4,5	4,8	4,8	5,6	7,4	8,7	8,7	8,7	
Вкупни депозити (со депозитни пари), годишна стапка на раст ^{/7}																											
	6,1	5,0	12,1	9,0	7,9	8,4	5,4	5,7	5,7	6,1	6,9	7,3	7,3	6,8	7,1	6,7	6,7	6,8	9,9	8,2	8,2	7,9	7,9	7,5	7,5	7,5	
Вкупни депозити на население	2,5	6,1	9,5	7,9	8,6	8,7	6,1	4,6	4,6	4,7	5,2	5,2	5,2	4,7	4,8	4,2	4,2	4,3	7,4	6,9	6,9	7,2	7,1	7,1	7,1	7,1	
Вкупни депозити на претпријатија	13,4	2,1	9,5	14,6	12,5	11,2	8,0	10,1	10,1	12,0	13,7	12,9	12,9	14,3	16,0	16,7	16,7	17,1	20,2	15,6	15,6	13,9	13,7	11,6	11,6	11,6	
Каматни стапки ^{/8}																											
Каматна стапка на БЗ (крај на месец/квартал/година)	3,75	3,25	2,50	2,25	1,75	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	
Активни каматни стапки																											
денарски	7,0	6,6	6,1	5,6	5,3	5,3	5,1	5,1	5,2	5,0	5,0	5,0	5,0	5,0	4,9	4,9	4,9	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,7	4,7	4,7	4,9	
дизини (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	5,7	5,3	4,9	4,6	4,4	4,3	4,3	4,2	4,3	4,2	4,2	4,1	4,2	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,0	4,1	4,1	
Пасивни каматни стапки																											
денарски	2,5	2,2	2,0	1,9	1,6	1,5	1,4	1,4	1,5	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,2	1,2	1,2	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,2	
дизини (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	1,0	0,9	0,8	0,8	0,7	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	
IV. Надворешен сектор индикатори																											
Биланс на тековна сметка (во милиони ЕУР)																											
Биланс на тековна сметка (% од БДП)	-275,5	-102,9	-7,12	-368,3	-155,68	-90,0	-50,6	-69,9	-366,2	29,3	-68,0	-17,0	-55,7	-115,2	-8,3	0,2	-123,3	88,7	-8,6	18,0	98,0						
	-2,9	-1,0	-0,07	-3,3	-1,45	-0,8	-0,5	-0,6	-3,4	0,2	-0,6	-0,1	-0,5	-1,0	-0,1	0,0	-1,0	0,8	-0,1	0,2	0,8						
Трговски биланс (во милиони ЕУР) ^{/9}																											
Трговски биланс (% од БДП)	-1.786,2	-1.816,2	-1.811,4	-2.007,7	-511,04	-384,3	-390,6	-530,7	-1.816,6	-96,4	-201,4	-231,9	-529,63	-274,6	-206,6	-223,9	-705,1	-218,1	-238,3	-161,2	-617,6	-248,3	-263,8	-351,2	-863,3	-2.715,7	
Увоз (во милиони ЕУР)	-6.176,5	-6.834,9	-7676,3	-8441,0	#####	-1.426,9	-1.996,8	-2.252,0	-7.594,5	-623,7	-746,6	-820,5	-2.190,8	-891,6	-753,7	-807,6	-2452,9	-805,2	-804,4	-725,7	-2335,3	-837,2	-878,1	-943,9	-2.659,3	-9.638,3	
Извоз (во милиони ЕУР)	4.390,3	5.018,7	5872,4	6433,3	1.407,72	1.042,6	1.606,2	1.721,4	5.777,9	527,3	545,2	588,6	1.661,2	617,0	547,1	583,8	1747,8	587,1	566,2	564,5	1717,7	588,9	614,3	592,7	1.795,9	6.922,6	
стапка на раст на увозот (годишна)	6,5	10,7	12,3	10,0	-3,60	-31,9	-3,4	-1,4	-10,0	5,5	3,7	35,1	14,2	138,5	65,5	35,1	71,9	12,3	33,3	7,3	17,0	9,5	26,3	19,1	18,1	26,9	
стапка на раст на извозот (годишна)	7,4	14,3	17,0	9,6	-8,25	-35,9	-1,7	5,1	-10,0	15,4	4,9	36,6	18,0	192,0	61,2	18,7	67,6	13,2	13,0	-3,8	6,9	-1,4	6,2	8,7	4,3	19,8	
Странски директни инвестиции (во милиони ЕУР)																											
	316,9	180,0	603,7	363,3	123,24	-8,6	-8,2	48,3	154,7	-45,9	20,5	11,9	-13,5	99,2	27,8	79,5	206,5	-19,2	13,7	21,0	15,5						
Надворешен долг																											
Бруто надворешен долг (во милиони ЕУР)	7.216,6	7.372,5	7.843,7	8.154,4	8295,5	8770,9	9068,8	8536,1	8.536,1				9.809,0				10.169,9				9.870,3						
јавен сектор	3.445,3	3.461,8	3.756,2	3.836,6	3816,5	4460,3	4644,6	4301,4	4.301,4				5.202,9				5.458,7				5.157,3						
јавен сектор/БДП (во %)	35,7	34,5	35,1	34,2	35,4	41,4	43,1	40,0	40,0				44,0				46,2				43,6						
приватен сектор	3.771,2	3.910,7	4.087,5	4.317,8	4478,9	4310,5	4424,1	4234,6	4.234,6				4.606,1				4.711,2				4.713,1						
Бруто надворешен долг/БДП (во %)	74,7	73,4	73,3	72,7	77,0	81,5	84,2	79,3	79,3				83,0				86,0				83,5						
Бруто девизни резерви (во милиони ЕУР) ^{/10}																											
	2.613,4	2.336,3	2.867,1	3.262,6	3.017,3	3.639,7	3.480,2	3.359,8	3.359,8	3.335,7	3.298,0	3.939,2	3939,2	4.003,5	4.019,8	4.031,1	4.031,1	3.547,6	3.691,6	3.690,7	3.690,7	3.650,4	3.571,4	3.643,3	3.643,3	3.465,1	

^{/1} Во пресметките на релативните индикатори, до 2020 година користен е БДП од официјалното соопштение на ДЗС. За 2021 година се користи проектираното ниво од последниот циклус на макроекономски пресметки на НБРМ.


^{/2} Податоците за 2021 година се проценети, а за 2020 година се претходни (Соопштение за квартални податоци за БДП од 07.12.2021

Странска ефективна побарувачка
(годишни промени во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Странска ефективна инфлација
(годишни стапки во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Курс евро/САД-долар



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.


Vlerësimet më të fundit për kërkesën e huaj efektive për vitin 2021 nuk kanë ndryshuar në krahasim me parashikimet e tetorit, pra pritet të jetë ende 4,1%. Për dy vitet e ardhshme, korrigjimet në projeksione janë në kaje të kundërta. Konkreisht, për vitin 2022 është bërë rishikim në rënie, ku rritja aktualisht pritet të jetë 3,9% (4,3% në tetor), ndërsa për vitin 2023 parashikohet rritje më e lartë, prej 2,8% (2,3% në tetor). Rishikime të këtilla janë kryesisht rezultat i vlerësimeve të aktivitetit më të ulët ekonomik të Gjermanisë¹ dhe Greqisë në vitin 2022 dhe më i lartë në vitin 2023.

Inflacioni i huaj efektiv i realizuar në vitin 2021 është 2,7% dhe është më i lartë se vlerësimet e muajit tetor (2,2%). Edhe për dy vitet e ardhshme është bërë rishikim në rritje, ku pritet që inflacioni i huaj efektiv të arrijë në 3% dhe 2% përkatësisht në vitin 2022 dhe 2023 (2% dhe 1,7% në tetor). Rishikimi në rritje vjen si pasojë e vlerësimeve për inflacion më të lartë në pothuajse të gjithë partnerët tanë të importit dhe Gjermania, Bullgaria dhe Serbia kanë kontributin më të madh pozitiv në rishikimin në rritje mesatarisht për tre vitet e fundit².

Në vlerësimet e fundit të kursit të këmbimit euro/dollar amerikan, është bërë rishikim në rritje për vitin 2022, duke pritur fuqizim më të madh të vlerës së dollarit amerikan në raport me euron. Ndryshime të këtilla janë kryesisht rezultat i pritjeve për shtrëngim më të shpejtë të politikës monetare nga FED-i krahasuar me BQE-në gjatë vitit 2022. Nga ana tjetër, për vitin 2023 është bërë korrigjim i vogël në rënie, ku ende pritet zhvlerësimi i dollarit amerikan ndaj euros.

¹ Rritja e Gjermanisë parashikohet në 2,8%, 3,7% dhe 2,6% përkatësisht në 2021, 2022 dhe 2023, nga 3%, 4,4% dhe 1,8% përkatësisht në tetor.

² Inflacioni në Serbi dhe Kroaci është përshtatur për ndryshimet e kursit të këmbimit.



Në vitin 2021, çmimi i naftës³ në bursat botërore shënoi rritje të lartë prej 61% (i shprehur në euro), që është pak më i lartë se pritshmëritë e tetorit. Për vitin 2022 është bërë rishikim në rritje, me rritje dukshëm më të lartë nga parashikimet e tetorit që po parashikohet aktualisht. Ky korrigjim është kryesisht për shkak të pritjeve për ulje të ofertës, në kushtet e stokeve të ulëta globale të naftës, uljes së interesit për investime në industrinë e naftës si rezultat i kalimit në burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe tensioneve aktuale gjeopolitike.

Nga ana tjetër, për vitin 2023 është bërë një rishikim i vogël në rënie, duke pritur ende rënie të çmimit të naftës.



Në vitin 2021, çmimet e bakrit dhe nikelit shënuan rritje të fortë përkatësisht me 46,1% dhe 29,6% (të shprehura në euro), pak më të larta se sa ishte parashikuar në tetor. Për vitin 2022 është bërë rishikim në rritje, veçanërisht për çmimin e nikelit dhe pritjet e tyre më të lartë se sa ishte parashikuar. Lëvizjet në rritje të bakrit janë kryesisht rezultat i inventareve të ulëta globale dhe pengesave në zinxhirët e furnizimit, ndërsa në nikel kjo është kryesisht për shkak të kërkesës më të lartë nga industria e makinave elektrike (bateritë), mes reduktimit të inventarëve të nikelit. Për vitin 2023, vlerësimet janë rishikuar në rënie, me rënie më të madhe të çmimit të bakrit dhe nikelit nga pritshmëritë e tetorit.

Çmimet e produkteve ushqimore në vitin 2021 shënuan rritje të ndjeshme, e cila është pak më e lartë se sa ishte parashikuar në tetor.

Për vitin 2022, vlerësimet janë rishikuar në rritje,

³ Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore primare, përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO, OPEC, BOE-së dhe portaleve të specializuara ekonomike ndërkombëtare.


Цени на пченицата и пченката во евра
(годишни промени во %)



Извор: ММФ и пресметки на НБРСМ.

me rritje më të madhe të çmimit të grurit dhe rritje në vend të uljes së çmimit të misrit. Lëvizjet në rritje të grurit ishin kryesisht për shkak të shqetësimeve të investitorëve për ndërprerje të mundshme në kanalet e furnizimit nga rajoni i Detit të Zi për shkak të situatës së tensionuar në Ukrainë, ndërsa në misër, ajo reflektoi pritshmëritë për prodhim më të ulët të misrit në Argjentinë dhe Brazil. Për vitin 2023 pritet ende një rënie e çmimeve të produkteve ushqimore, e cila është disi më e ulët për grurin dhe më e lartë për misrin krahasuar me pritjet në tetor.

Едномесечен Еурибор
(квартален просек, во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Për sa i përket EURIBOR-it njëmuojor, nuk priten devijime të mëdha nga projeksioni i tetorit në vitin 2022 (-0,49%, kundrejt -0,51% në tetor). Nga ana tjetër, një rishikim më i rëndësishëm në rritje është bërë për vitin 2023, ku aktualisht pritet që në gjysmën e dytë të vitit EURIBOR-i njëmuojor të kalojë në zonën pozitive dhe mesatarisht për të gjithë vitin të jetë në 0% (-0,4% në tetor). Lëvizje të këtilla vijnë kryesisht nga pritshmëritë e investitorëve për shtrëngim gradual të politikës monetare nga BQE-ja, duke filluar nga fundi i vitit 2022, e cila do të pasohet me lëvizje edhe gjatë vitit të ardhshëm.

Стапка на инфлација

(годишни придонеси во вкупната инфлација, во п.п.)



Në janar 2022, **çmimet e konsumit vendas** u rritën me 1,5% në baza mujore (0,4% në muajin paraardhës), kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë,⁴ kryesisht si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për amvisëritë, si dhe kontribut shtesë gjithashtu kishin çmimet më të larta të naftës, në pajtueshmëri me rritjen e çmimeve të derivateve të naftës në bursat botërore. Gjithashtu, një kontribut të rëndësishëm ka pasur edhe rritja e çmimeve të ushqimeve⁵ (me rritje më të theksuar të çmimeve të perimeve, frutave dhe kategorisë së çmimeve "bukë dhe produkte drithëra"). Nga ana tjetër, kontributin më të madh negativ e ka rënia e çmimeve të transportit ajror, si dhe ulja e çmimeve të këpucëve.

Shkalla vjetore e inflacionit në janar ishte


6,7% (4,9% në dhjetor), me përshpejtimin e rritjes vjetore dhe kontributin e çmimeve në komponentët e energjisë dhe ushqimit.

Shkalla e inflacionit vjetor të realizuar në muajin janar është mbi shkallën e projektuar nga cikli i projeksioneve të tetorit, me devijim më të madh në rritje në komponentin energjetik dhe atë ushqimor dhe minimal në komponentin bazë.

Shkalla bazë e inflacionit në muajin janar

ishte 0,3% me bazë mujore (0,7% në muajin paraardhës). Në bazë vjetore, shkalla bazë e inflacionit është 3,2% (2,9% një muaj më parë), ku kontributin më të lartë pozitiv e kanë çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele, të plotësuara nga çmimet e transportit ajror dhe në masë të vogël edhe nga çmimet e makinave, pajisjeve informative, produkteve të higjienës personale, pijeve joalkoolike, si dhe çmimeve të produkteve farmaceutike.

Придонеси кон годишната стапка на инфлацијата (во п.п.)




⁴Sipas vendimit të Komisionit Rregullativ për Energji të RMV-së të datës 30.12.2021, çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal "EVN HOME" Sh.P.K. Shkup nga 1 janari 2022 rritet për 9,48% (<https://www.erc.org.mk/pages.aspx?id=153>). Gjithashtu, kontribut të vogël në rritjen e çmimeve të energjisë në janar 2022 është vendimi për rritjen e çmimit final të energjisë termike të dorëzuar mesatarisht për 14,05% për tri kompanitë në territorin e qytetit të Shkupit, i miratuar nga RKE e RMV-së më 31.12.2021 (<https://www.erc.org.mk>).

⁵ Më 4 dhjetor 2021, Qeveria e RMV-së mori vendim për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë (bukë, sheqer, miell, vaj luledielli ushqimor, qumësht, mish të freskët dhe produkte të mishit të kuar, djathë dhe gjizë) në nivelin e1 dhjetorit. Më 14 dhjetor, lista e produkteve u zgjerua duke përfshirë çmimet e orizit, vezëve dhe makaronave. Vendimi për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë nga fillimi i dhjetorit është i përkohshëm, i vlefshëm deri më 28 shkurt 2022 (në pajtim me vendimin shtesë të Qeverisë së RMV-së të datës 28 janar 2022). Pavarësisht ngrirjes, sërish shohim rritje në kategorinë e përgjithshme ushqimore, kryesisht për shkak të rritjes së kategorive të tjera të produkteve që nuk mbulohen nga vendimi për ngrirjen e çmimeve.

Инфлација и цени на храната и енергијата

(годишни промени, во %)



Странски ефективни* и домашни цени на храна

(индекси, 2005 = 100)



* Ефективните странски цени на храна се добиени како пондериран збир од цените на храната во земјите што се најзначајни трговски партнери на Северна Македонија.
Извор: ДЗС, Еуростат и пресметки на НБРСМ.

Нë lidhje me lëvizjet e pritshme të çmimeve të supozuara të inputit të jashtëm në projeksionin e inflacionit, rishikimet janë në drejtim rritës, i cili së bashku me realizimet më të larta se parashikimet, krijon rreziqe në rritje për normën e parashikuar të inflacionit në vitin 2022.

Në të njëjtën kohë, theksohet më tej pasiguria dhe dinamika e lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, e cila korrespondon me efektet e pasigurta ekonomike që lidhen me zhvillimin dhe trajtimin e pandemisë dhe tensionet aktuale gjeopolitike, si dhe pasiguria e shtuar e tregjeve botërore të karburanteve.

Në nëntor 2021, rritja nominale vjetore e pagës mesatare neto ishte 5,6% (4,5% në muajin paraardhës).

Rritja e pagës minimale me 1,7% në prill 2021, në pajtim me rregullimin e rregullt ligjor, kontribuon pjesërisht në rritjen vjetore të pagave⁶.

⁶Në prill 2021 u krye rregullimi për rritjen e pagës minimale (me rritjen për vitin paraardhës të pagës mesatare të paguar në RMV-së, indeksit të koston të jetesës dhe rritjes reale të PBB-së – një e treta e rritjes. në secilin tregues, përkatësisht). Sipas njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, botuar në "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 80/21 për zbatimin e Ligjit e Pagesës Minimale në Republikën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/19 dhe 239/19), paga minimale neto është rritur për 260 denarë. Shuma e pagës minimale në bruto, duke filluar nga prilli 2021 deri në mars 2022, është 22.146 denarë (më parë 21.776 denarë), gjegjësisht paga minimale në shumën neto është 15.194 denarë (më parë 14.934 denarë)

Просечна исплатена плата
(годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.

Përshejtim i rritjes vjetore të pagave në muajin nëntor vihet re pothuajse në të gjitha aktivitetet, dhe më i theksuar në aktivitetet që kanë të bëjnë me "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike", "administratën publike dhe mbrojtjen"⁷ dhe "aktivitetet financiare dhe veprimtaritë e sigurimit", ku është regjistruar dhe rritje mujore më e theksuar.

Me rritjen e shpenzimeve të jetesës në bazë vjetore, **rritja reale vjetore e pagës neto në muajin nëntor ishte 0,8%**

Просечна исплатена месечна нето-плата по сектори
(номинални годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.


Rritja e pagave nominale dhe reale vjetore e realizuar në periudhën tetor-nëntor 2021 (përkatësisht 5% dhe 0,6%) aktualisht është më e ulët se pritet për rritjen e pagave në tremujorin e katërt 2021, në kuadër të projeksionit të tetorit.

Të dhënat me frekuencë të lartë për kahun e ofertës dhe kërkesës që disponohen për tremujorin e katërt të vitit 2021 tregojnë kryesisht për rritje të mëtijshme, por më të ngadaltë vjetore të aktivitetit ekonomik në këtë pjesë të vitit. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë⁸, rezultatet e anketave për tremujorin e katërt të vitit tregojnë për perceptime pak më pak të favorshme krahasuar me tremujorin paraardhës, në kuadër të përhapjes së valës së pestë të

⁷ Rritja e pagave në këtë aktivitet është e lidhur me vendosjen e së drejtës për shtesë në pagë për disa punonjës të institucioneve qendrore të pushtetit ekzekutiv. Të drejtën e shtesës së pagës deri në 30% të pagës së rregullt mund ta ushtrojnë punonjësit për shkak të specifikës së punës dhe detyrave të punës dhe rritjes së vëllimit të punës, si dhe për arritjen e rezultateve të jashtëzakonshme në shërbim të interesit publik dhe kryerjen efikase të kompetencave të tyre (<https://vlada.mk/node/26128>, <https://vlada.mk/node/26151>).


⁸ Ai i referohet sondazheve të kryera nga Komisioni European për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik përfshihet si një mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë individualë të ekonomisë (ndërtim, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Индикатор на економска доверба и БДП



pandemisë e lidhur me llojin “omikron” të Kovid-19. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë, rezultatet e anketave për tremujorin e katërt të vitit tregojnë për perceptime pak më pak të favorshme krahasuar me tremujorin paraardhës, në kuadër të përhapjes së valës së pestë të pandemisë e lidhur me llojin “omikron” të KOVID-19. Megjithatë, perceptimet e subjekteve ekonomike janë dukshëm më të favorshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjë që tregon për vazhdimin e rimëkëmbjes ekonomike edhe në këtë periudhë vitin e kaluar. Për periudhën e ardhshme, rezultatet e anketës së fundit në janar 2022 tregojnë një perceptim më të favorshëm për gjendjen e ekonomisë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Економски сектори
(реални годишни промени, во %)



* Прост просек од годишните стапки на промена на различните видови на транспорт и телекомуникациите.
Извор: ДЗС и пресметки на НБРСМ.

Тë dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë në kahun e ofertës për tremujorin e katërt të vitit tregojnë lëvizje në drejtime të ndryshme, por gjithsesi në përgjithësi, ato tregojnë për rritje të mëtejshme, por më të moderuar vjetore.

ИНДУСТРИСКО ПРОИЗВОДСТВО И ОСТАНАТИ ЕКОНОМСКИ ДЕЈНОСТИ


	2019				2020				2021							
	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	окт.	ное.	дек.	
	реални годишни промени во %															
Бруто домашен производ	2.8	6.1	4.3	2.5	-1.3	-16.4	-5.9	-0.8	-1.8	13.4	3.0	-	-	-	-	-
Индустриско производство	8.8	1.1	7.1	-1.3	-3.7	-25.0	-7.5	-2.3	-6.1	22.2	-3.5	-2.3	-6.5	4.7	-4.9	-
Извршени градежни работи	15.1	-3.3	3.0	5.3	6.3	-5.1	3.0	2.3	-1.1	-9.6	-10.8	-	-5.4	-35.7	-	-
Високоградба	-9.3	5.1	23.7	-1.1	-8.5	-20.4	17.9	-8.6	18.5	5.3	-20.2	-	15.1	-12.3	-	-
Нискоградба	58.3	-8.0	-6.7	11.1	21.3	4.7	-6.2	11.1	-16.1	-16.9	-3.5	-	-16.1	-46.7	-	-
Промет во трговијата - Вкупно*	13.9	12.8	15.3	15.5	-16.7	-30.6	-26.1	-24.3	0.9	22.5	16.9	10.4	9.6	11.8	9.8	-
Промет во трговијата на мало*	7.6	8.8	12.0	13.8	1.0	-18.6	-15.7	-15.5	-1.3	18.3	13.9	10.0	10.8	13.3	6.4	-
Промет во трговијата на големо*	18.0	16.0	18.1	17.3	-27.8	-40.1	-38.7	-36.3	3.7	27.9	28.4	19.6	19.9	23.8	15.7	-

* Реалните стапки на раст се пресметани од НБРСМ, со деление на номиналните стапки на раст со годишната инфлација, мерена според трошоците на живот. Податоците за трговијата во 2020 и 2021 година се претходни податоци, дадена податоците за БДП во 2019 година се претходни, а за БДП во 2020 и 2021 година се проценети.
Извор: ДЗС и пресметки на НБРСМ.

